

Pëllumb XHUFI

BRDA, APO BARDHA?

Në shek. XVIII, kur filloi të marrë formë, Principata e Malit të Zi (Crnagora-Montenegro), me qendër Cetinjën, përfshinte pak a shumë territorin e brendshëm kodrinor e malor të pesë nahijeve: Cernica, Rijeka nahija, Katunska nahija, Ljeshanska nahija dhe Pjeshivačka nahija.¹ Nga ai moment, historia e principatës është një histori zgjerimi të vazhdueshëm në të gjithë krahët.² Në perëndim ajo aneksoi viset bregdetare me Kotorin, Budvën, Tivarin e Ulqinin, të njohura prej shek. XV si “*Albania Veneta*”.³ Në veri e në jug u shtri duke marrë Nikshiqin e Podgoricën me Zhabjakun, kurse në krahun lindor, Mali i Zi mori një trevë të gjerë malore, që për shekuj kishte qenë shpirti i qëndresës kundër sundesit osman⁴. Kjo trevë ka qenë banuar nga fiset e njohura të Kuçit, Pipërit, Bratoneshit e Palabardhit (Bjelopavliqit)⁵. Palabardhët u përfshinë të parët në shtetin

¹ Sir J. Gardner Wilkinson, *Dalmatien und Montenegro, mit einem Ausfluge nach der Herzegowina*, I. Band, Leipzig: Verlag von Gustav Mayer, 1849, f. 233; Hilarion Ruvarac, *Montenegrina. Priloshci istoriji crne gore*, bot. dytë, Zemun: Jovan Pulo, 1899, f. 63; Kurt Hassert, *Beiträge zur physischen Geographie von Montenegro*, Gotha: Justus Perthes, 1895, f. 51-53; Elizabeth Roberts, *Realm of the Black Mountain. A History of Montenegro*, London, Hurst&Company, 2007, f. 12.

² Elizabeth Roberts, *Realm of the Black Mountain. A History of Montenegro*, f. 3.

³ Oliver Jens Schmitt, *Arbëria Venedike, 1392-1479*, Tiranë: botimet K&B, 2007, f. 19-20.

⁴ Bernhard Schwarz, *Montenegro. Schilderung einer Reise durch das Innere*, Leipzig: Paul Froberg, 1883, f. 437; Kurt Hassert, *Beiträge zur physischen Geographie von Montenegro*, Gotha: Justus Perthes, 1895, f. 52.

⁵ “*le quattro popolationi de Piperi, Brattonesi, Bielopaulovicchi e Cucchi*”, shih: Biblioteca Civica (ex Comunale) di Fermo, Mss. It., C. B. XXX nr. 45: “Relatione Universale dell’origine e successe della missione Apostolica de Frati Minori Osservanti Riformati del Serafico S. Francesco nel Regno d’Albania. Da diverse relationi d’alcuni Padri Missionari di dette missioni raccolta, ordinata et aumentata dal P. Giacinto Sospello, anno 1652, fol. 9. Duhet patur parasysh, se territori i zënë nga katër fiset në fjalë, pësoi në kohë tkurje e zgjerime nëpërmjet bashkimit të fiseve të veçanta, apo shkëputjes së tyre nga bashkësia (*confederatio*) e maleve të asaj ane. Kështu, në mars të vitit 1688, aty përmenden jo 4, por 8 fise: Kuçët, Kelmendët, Hotët, Grudët, Vasoeviqët, Bratoneshët, Piprët e Palabardhët (Bjelopavliqët). Nga ana tjetër, nuk mungojnë rastet kur nga një fis i caktuar shkëputet

malazez, aty nga fundi i shek. XVIII, e shembullin e tyre e ndoqën edhe fiset e tjera.⁶ Nga ai moment shfaqet në aktet zyrtare emri *Brda*, me të cilin përmblidheshin territoret e të gjitha atyre katër fiseve. Ky zhvillim pati rëndësi të madhe në jetën e principatës malazeze. Jo më kot, këtej e tutje ajo fillon të quhet “*principata e Crnagorës dhe e Brdës*”, e po ashtu princi Pjetër I Petroviç Njegushi nis të prezantohet me titullin e plotësuar, si “*princ i Crnagorës dhe i Brdës*”.⁷ Dëshmia e parë duket se është një vendim i kuvendit të krerëve të Crnagorës i vitit 1798, ku u bëhej thirrje crnagorasve që të bashkoheshin “*me vëllezërit brdjanë*” (nashu bradju Brdjane), në luftën kundër osmanëve.⁸ Nga ajo kohë, termat “*Brda*”, për vendin, dhe

njëra degë e tij, duke formuar një fis të ri të mëvetshëm. Ky është rasti i fisit Vasoë (Vasojeviq). Defteri i Sanxhakut të Shkodrës (1485), na mëson se atë kohë fshati Vasojeviq ishte pjesë përbërëse e bashkësisë së Piprëve (S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Tiranë: Akademia e Shkencave, 1974, f. 371). Por në fund të shek. XVI, fisi Vasojeviç u shkëput nga Piprët duke krijuar një njësi më vete. Kështu, në 31 mars të vitit 1688, siç u tha më sipër, emri i tyre shfaqet bashkë me fiset e Kuçëve, Kelmendëve, Hotëve, Grudëve, Bratoneshëve, Pipërve e Palabardhëve (Bjelopavliqëve) si pjesë e lidhjes së popujve “të maleve të Shqipërisë”. Shih: ASVe, *Provveditori da Terra e da Mar e altre cariche*, b. 360: raport i Antonio Bernardo, Provveditor i Përgjithshëm për Dalmacinë e Shqipërinë, Zara, 31 mars 1688; Giuseppe Modrić, *La Dalmazia Romana. Note e ricordi di viaggio*, Roma: L. Roux, 1892, f. 316; Kurt Hassert, *Beiträge zur physischen Geographie von Montenegro*, Gotha: Justus Perthes, 1895, f. 51-53; Slaven Bertosa, “Nastanjenici i prolaznici dubrovačke Republike, Boke Kotorske i Mletačke Albanije u Puli (17.-19. sotjeće”, *Analı Dubrovnik* 41 (2003), f. 165-166; Gordana Gorunović, “Mihajlo Lalić and Serbian Ethnology: Ethnography and Mimesis of Patriarchal Society in Montenegrin Highlands”, in: *Etnoantropološki Problemi*, seri e re, viti XII, fl. 4 (2017), f. 1212; J. Gardner Wilkinson, *Dalmatien und Montenegro, mit einem Ausfluge nach der Herzegowina*, f. 233, 239.

⁶ Johann Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, Jena: Friedrich Mauke Verlag, 1854, f. 114; J. Gardner Wilkinson, *Dalmatien und Montenegro, mit einem Ausfluge nach der Herzegowina*, f. 233.

⁷ J. Gardner Wilkinson, *Dalmatien und Montenegro*, f. 233; K. Hassert, *Beiträge zur physischen Geographie von Montenegro*, f. 66; William Miller, *The Ottoman Empire and its successors, 1801-1913*, Cambridge, University Press, 1913, f. 142, 143; *Naučno delo*, Posebna izdanja, Vol. 4-8, Beograd: Etnografski Institut. Srpska akademija nauka i umetnosti, 1952, f. 101 (“Када, за владе Петра I, црногорску држави приступе Белопавличи, па после и остала Брда, онда је, званично, „Црна Гора и Брда”).

⁸ Radmila Petrović, *Zakonik Petra I, vladike crnogorskog. Istorisko-prava rasprava*, separat nga: *Zapisi*, knj. IV, 1929, f. 15. M. Pantić ka vënë re, që krerët malazezë, pikërisht duke i quajtur “vëllezër” banorët e Brdës, nënvizojnë dallimin që ekzistonte atë kohë mes tyre. Në fakt, integrimi i këtyre popullsive në kontekstin shtetëror të Malit të Zi nuk rezultoi si një proces i lehtë. Ai u shoqërua me konflikte e përplasje të tyre me autoritetin e shtetit malazez, ku përbërja e ndryshme etniko-fetare luajti një rol të rëndësishëm. Për t’u përmendur është e ashtuquajtura “Nata malazeze e Shën Bartolomeut”, 28 dhjetor 1702,

“*brdjanë*”, për banorët, në dukje fjalë sllave, hynë në përdorim zyrtar duke u bërë pjesë e terminologjisë gjeo-politike të Malit të Zi.⁹ Pas autorëve sllavë, ato i huazuan edhe historianë e studjues të huaj që u interesuan për historinë e etnografinë e Malit të Zi e, në përgjithësi, të Ballkanit.¹⁰

Por, duhet thënë se emri “*Brda*” do të ishte një *absurdum* në rast se atë do ta lidhnim me fjalën sllave “*brda*”. Në fakt, kuptimi i kësaj fjale është “*kodër*” (gjerm. *Hügel*, frëng. *colline*).¹¹ Në të kundërtën, Brda, nga Palabardhi (Bjelopavliqi) në skajin veriperëndimor, deri në Kuç, në skajin

kur mbi popullsinë muslimane të Crnagorës u krye një ployë e padëgjuar e urdhëruar nga Vladika i Madh, Danilo Njegush. Po ashtu, vetëm disa vjet pas bashkimit të tyre me Malin e Zi, më 1843, fisi i Kuçëve ngriti krye pas heqjes së privilegjeve e vendosjes së taksave nga pushteti malazez. Shih: Miroslav Pantić, *Književnost na Crne Gore i Boke Kotorske od XVI do XVIII veka*, Beograd: Srpska književna zadruga, 1990, f. 28-29; J. Gardner Wilkinson, *Dalmatien und Montenegro, mit einem Ausfluge nach der Herzegowina*, f. 233-234; Bernhard Schwarz, *Montenegro. Schilderung einer Reise durch das Innere*, Leipzig: Paul Froberg, 1883, f. 436.

⁹ Jovan Tomić, *Crna Gora za morejskog rata (1684-1699)*, Beograd, 1907, f. 159-160; Gligor Stanojević, “Pokret Brdskih i Albanskih plemena uoči Kandiskog rata”, në: *Istorijski Zapisi*, god XIII, knj. 17, nr. 3, 1960, f. 513-516; *Po ai*, “Crnogorska i Brdska plemena u vrijeme austrijsko-ruskog rata protiv turske (1735-1739)”, *Istorijski Zapisi*, XIX/3-4 (1962), f. 377-398; Jovan Erdeljanovic, *Stara Crna Gora. Etnicka prošlost i formiranje crnogorskih plemena*, Beograd: Sllovo Ljube, 1978, f. 81, 363, 484; Rajko Veselinović, “O rezultatima polemike o metodu dokumentacije i o etničkim postulatima jedne odbrane radi odbrane”, *Istorijski Glasnik* 3-4 (1960), f. 117, 123, 124; Miroslav Pantić, *Književnost na tlu Crne Gore i Boke Kotorske od XVI do XVIII veka*, Beograd: Srpska književna zadruga, 1990, f. 66; Branislav Đurđev, *Postanak i razvitak Brdskih, Crnogorskih i Hercegovačkih plemena*, Odabrani Radovi, Titograd: Crnogorska Akademija Nauka i Umjetnosti, 1984, *passim*; Goran Sekulović, *Trpeljivost-Plata Ljudskosti. O Jovanu Baljeviću, prvom Crnogorcu doktoru filozofije 1728-1769*, Podgorica: Dukljanska Akademija Nauka i Umjetnosti, 2015, f. 14-16; Gordana Gorunović, “Mihajlo Lalić and Serbian Ethnology: Ethnography and Mimesis of Patriarchal Society in Montenegrin Highlands”, in: *Etnoantropološki Problemi*, seri e re, viti XII, fl. 4 (2017), f. 1212.

¹⁰ J. Gardner Wilkinson, *Dalmatien und Montenegro, mit einem Ausfluge nach der Herzegowina*, f. 233; Johann Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, f. 187; Constantin Jireček, *Die Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien während des Mittelalters*, Prag: Böhmisches Gesellschaft der Wissenschaften, 1879, f. 69; Kurt Hassert, *Beiträge zur physischen Geographie von Montenegro*, f. 50-51, 66; William Miller, *The Ottoman Empire and its successors, 1801-1913*, Cambridge, University Press, 1913, f. 142; Elizabeth Roberts, *Realm of the Black Mountain. A History of Montenegro*, f. 18; Tea Mayhew, *Dalmatia between Ottoman and Venetian Rule*, Roma: Viella, 2008, f. 89...

¹¹ Petar Skok, *Etimologijski Rječnik Hrvatskoga ili Srpskoga Jezika*, knj. I (A-J), Zagreb: Jugoslovenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, 1971, f. 204-205; Jovan Erdeljanovic, *Stara Crna Gora. Etnicka prošlost i formiranje crnogorskih plemena*, Beograd: Sllovo Ljube, 1978, f. 776 (shih zërin “*brdo malo*”).

tjetër juglindor, është një krahinë thellësisht malore, me kreshta që kalojnë 2500 m, ku shquhet Komi i Kuçit, “*roi des montagnes de la Turquie*”, sipas përcaktimit të Ami Boué.¹² Ky fakt na shtyn ta kërkojmë tjetërkund kuptimin e termit “*Brdë*”, e jo sigurisht në fjalorin e gjuhës sllave. Ky, siç u tha më sipër, shënon me këtë fjalë një lartësi të moderuar, saktësisht kodrën, gjë që nuk përkon me terrenin e thyer malor të krahinës në fjalë.

Ndërkohë, emri i trevës së banuar nga fiset e Palabardhëve (Bjelopavliqëve), Pipërve, Kuçëve e Bratoneshëve shfaqet rreth dy shekuj më parë në burimet arkivore veneciane në formën “*Barda*”. Në tetor 1609, krerët e disa fiseve shqiptare, mes të cilëve edhe Lalë Drekali i Kuçëve, i premtonin Senatit të Venedikut se ishin gati të garantonin kalimin e lirë të postës veneciane nga Kotori në Stamboll e anasjelltas, duke ndjekur rrugën tokësore që kalonte nëpër Kelmend, Kuç e “fshatra të tjera të Bardas” (*et altre ville di Barda*).¹³ Një raport i pas një viti i rektorit venecian të Kotorit, Girolamo da Molin njoftonte Senatin për ekspeditën ndëshkimore që Pashai i Bosnjës kishte ndërmarrë atë kohë kundër “fshatrave të Bardas në Malet e Shqipërisë” (*le ville di Barda nei Monti d’Albania*).¹⁴ Rreth 80 vjet më vonë, dokumentat e Arkivit të Venecias flasin përsëri për krerët e Kuçëve, Kelmendëve, Hotëve, Grudëve, Vasojeviqëve, Bratoneshëve, Pipërve e Bjelopavliqëve, që përmbledhtas cilësohen aty si “*krerë të Bardas së Maleve të Shqipërisë*”.¹⁵ Në raste të tjera, gjithmonë kur i referohen krahinës së Barda-s, dokumentat e mjaftohen ta identifikojnë atë trevë me fjalët “*male të Shqipërisë*”, duke dhënë jo thjesht një koordinatë gjeografike, por etnogjeografike.¹⁶ Gjithësesi, ajo që mund të thuhet me siguri që tani, është

¹² Ami Boué, *La Turquie d’Europe*, tome I, Paris: Arthus Bertrand, 1840, f. 8, 12, 13; Kurt Hassert, *Beiträge zur physischen Geographie von Montenegro*, f. 64; Constantin Jireček, *Die Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien während des Mittelalters*, Prag: Böhmische Gesellschaft der Wissenschaften, 1879, f. 69; Jovan Erdeljanovic, *Kuči, Bratonozići, Piperi. Etnoloska Studija*, Beograd: Sllovo Ljubve, 1981, f. 7, 10.

¹³ ASVe, *Senato, Rettori et altre cariche: Dalmazia*, filza 8: 13 tetor 1609; *Po aty*, filza 9: 22 prill 1610.

¹⁴ ASVe, *Senato, Rettori et altre cariche: Dalmazia*, f. 9 (1610): Kotor, 7 shkurt 1611.

¹⁵ ASVe, *Prov. Terra Mar*, b. 360: raport i Antonio Bernardit, Proveditor i Përgjithshëm i Dalmacisë dhe i Shqipërisë, Zara, 31 mars 1688.

¹⁶ “*I popoli Cuzzi, Clementi et altri dei Monti d’Albania*”, “*Piperi, Bretonozi, et altri monti d’Albania*”, “*Capi de Popoli de Monti dell’Albania*”, “*gente raccolta da Monti, tra quali v’entrano Piperi, Cuzzi e Trabonesich*”, “*tutti li Capi delle Montagne d’Albania*”. Shih: ASVe, *Senato, Dispacci: Provveditori da Terra e da Mar e altre cariche*, b. 529: Split, 18 maj 1689; *po aty*, Cattaro, 11 maj 1689; *po aty*, Split, 5 qershor 1689; *po aty*, Cattaro, 1 tetor 1689; *po aty*, Split, 10 tetor 1689; *po aty*, 17 dhjetor 1689; ASV, *Senato, Dispacci: Provveditori da terra e da mar e altre cariche*, b. 530 (1689-1690): Mirditë, 15 maj 1690.

se dokumentet veneciane e lidhin pazgjdhmërisht emrin “Barda” me konceptin e malit. Ndërkohë, në gjuhën sllave fjala “Brda”, që shfaqet vonë në dëshmitë e shkruara, nënkupton një terren kodrinor, dhe, përsërisim, ky nuk është rasti i territorit të Bardas të banuar nga katër fiset.

Për arsye semantike e kronologjike, “Barda” e dokumenteve veneciane nuk mund të jetë një përshtatje e fjalës sllave “Brda” (kodër). Me shumë gjasë është e kundërta, dhe *Brda* sllave është një huazim i përshtatur i emrit *Barda*, që është emri i vjetër i vendit. Me këtë rast, po sjellim në vëmendje një letër të komunës së Kotorit, zotërim venecian, e shkruar në italishten dalmatine dhe dërguar Sinjorisë në 6 qershor 1698. Në të, komuna kërkon t’i ktheheshin Kotorit dy fshatra në rrethinat e tij, *Biela* dhe *Lodenizze*, të cilat ai qytet i kishte patur gjithmonë nën juridiksionin e vet. Në formulimin e kësaj letre, në një pasazh të saj, kancelari i komunës e gjen me vend t’u përkthejë anëtarëve të Senatit venecian fjalën sllave *Biela*, duke dhënë njëherësh edhe versionin italian të saj, “*Bianca*”.¹⁷ Por ndryshe nga kjo letër në italisht e komunës së Kotorit, në dokumentet e hartuara në sekretarinë e Senatit të Venedikut, e gjithashtu në ato të hartuara nga kancelaria e kurisë papale në Romë, emri në sllavisht i fshatit *Biela* nuk jepet në kalkun italisht të saj, *Bianca*, si në letrën e komunës së Kotorit. Jepet me një fjalë që nuk është as sllave e as italiane, por që domosdoshmërisht është një kalk i tyre dhe ka të njëjtin kuptim si ato: *Barda*, d.m.th. *Bardha*.¹⁸ Kaq mjafton për të konkluduar, se *Barda* e

¹⁷ “*Riserbò la divina provvidenza à questi gloriosissimi tempi la gratia, e con nostra centuplicata non solo con successivi trionfi estese il suo dominio sopra Biella e Ledenizze villaggi d’antica iurisdizione della città di Catharo, ma etiamdio sopra Risano suo territorio, et adiacenze, Castel Novo suo territorio...Noi suoi descendentì stante la dispositione già seguita dalla publica autorità delli territori di Biancha e Lodenizze in benefittio e remunerationi de benemeriti, non supplichiamo altro, che la dichiarazione che queste, cioè Biella e Lodenizze ritornino nell’antica iurisdizione de Catharo*”, shih: ASVe, Senato, Dispacci: Provveditori da Terra e da Mar e altre cariche, b. 539: Kotor, 6 qershor 1698.

¹⁸ ASVe, Sen. Mar, f. 39 (marzo-agosto 1568): 30 mars 1568 (*villa di Barda territorio di Cattaro*); ASV, Senato III (Secreta): Cattaro, f. 6 (1655): 30 prill 1655 (*villa di Barda*). Marko Jačov, *Spisi Kongregacije za propagandu vere u Rimu o Srbima, 1622-1644*, Zbornik za Istoriju, Jezik i Knjizhevnost srpskog naroda, Beograd: Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, 1986, nr. 33, f. 49, para datës 29 tetor 1625: (*villa di Barda*); *Po aty*, nr. 177, f. 281, Split, 1 shkurt 1637. Megjithatë, jashtë administratës së shtetit venecian e të kurisë papale, ndonjë udhëtar italian preferon ta thërrasë atë fshat në formën *Bianca*. Shih: Giuseppe de Brodmann, *Memorie politico-economiche della città e territorio di Trieste della penisola d’Istria, della Dalmazia fu Veneta di Ragusi e dell’Albania ora congiunti all’Austriaco Impero*, Venezia dalla Tipografia di Alvisopoli, MDCCCXXI, f.

dokumenteve veneciane i përgjigjet shqipes *Bardha*. Shëmbulli i atij fshati në afërsi të Kotorit me emrin sllav *Biela*, të cilin venecianët e përkthejnë me fjalën italiane *Bianca*, dhe akoma më shpesh *Barda*, provon katërcipërsisht se me këtë fjalë ata kuptonin fjalën shqipe *Bardha*. Asociacioni mearketipin, d.m.th. me trevën e “maleve Barda të Shqipërisë” është gjithashtu e qartë.

Në fakt, në trevat e banuara nga Shqiptarët, nocioni “Bardh” ndeshet shpesh, në një gjeografi shumë të shtrirë dhe, nënvizojmë, në reliev gjithnjë malor. Kujtojmë toponimet Mali Bardhë, afër Ulqinit, Mal i Bardhë në Fushë-Bulqizë, Mal i Bardhë në Kurbin, në veri-lindje të Laçit, afër të cilit ekziston edhe një lartësi tjetër e quajtur Guri i Bardhë. Një Mal i Bardhë ndodhet edhe në rrethin e Beratit, dhe një tjetër me po atë emër në rrethin e Përmetit. Mal i Bardhë quhet lartësia që ngrihet përballë Korabit, në Dibër. Një tjetër lartësi, dukshëm më e ulët, ndodhet aty pranë, por ajo në mënyrë domethënëse quhet *Kodra e Kuqe*, gjë që nënkupton ndryshimin në strukturë epërmasëqë ekziston midis dy lartësive.¹⁹ Në ekstremin jugor të Peloponezit, krahina e Manit, ku qysh së hershmi dëshmohet një popullsi shqiptare, e ushqyer herë pas here nga valë migruese të ardhura nga Shqipëria e Poshtme,²⁰ ekziston një territor malor me një kështjellë të fuqishme, e cila nga shek. XV u bë vatra e qëndresës së banorëve shqiptarë të asaj ane kundër invazorëve osmanë.²¹ Ky vend quhet *Bardhunjë*, dhe nuk është një rastësi, që në ekstremin tjetër verior, në malet e Bardhës, saktësisht në vendet e banuara nga fisi i Kuçëve, ekziston një vend me emrin e ngjashëm, *Bardhanjë*.²² Në fund, nuk është pa interes të evidentohet ekzistenca e një mali omonim, rreth 1500 m i lartë, në veri të Gjirit të Kotorit, në lindje të malit Orjen. Emri i tij është në gjuhën sllave, *Bijela Gora*.²³ Këtu jemi në një trevë të sllavizuar qysh në shek. VII, kur mbi popullsinë e vjetër iliro-romane u mbivendosën popullsitë e porsaardhura sllave të Zaklumëve, Kanalitëve e Tërbunëve.²⁴ Një dukuri e tillë nuk

315: “*Comune di Cattaro, delli distretti di Lustizza, Cartoli, Zuppa, Dobrota, Ledenizze, Bianca e lo Scoglio delli Stradiotti al Teodo*”.

¹⁹ Shih: *Regno d’Albania*, Rilievi dell’Istituto Geografico Militare, Firenze, 1939.

²⁰ Constantin Sathas, *Documents inédits relatifs à l’histoire de la Grèce au Moyen Âge*, vëll. I, Paris, 1880, f. 16.

²¹ Megale Elleniké Egkyklopaideia “Pyrsoi”, tomos 17, Athenai: Pyrsoi, 1931, f. 512.

²² Mark Milani, *Jeta dhe zakonet e shqiptarëve*, Tiranë: Muza, 2003, f. 39, 124; Jovan Erdeljanovic, *Kuci, Bratonozići, Piperi. Etnoloska Studija*, f. 83, 92.

²³ K. Hassert, *Beiträge zur physischen Geographie von Montenegro*, f. 54.

²⁴ Konst. Porphyrogenetus, *De Administrando Imperio*, ed. G. Moravcsik, përkth. angl. R. Jenkins, Budapest, 1949, f. 153.

dëshmohej të ketë ndodhur në trevat në jug të Gjirit të Kotorit, në Diokle, ku vazhdoi të mbizotërojë edhe për shumë shekuj popullsia e vjetër iliro-romane.²⁵

Emri *Bardhë*, që përfshin vendbanimet Bjelopavliq, Pipër, Bratonesh e Kuç, nuk është i vetmi emër shqip në atë trevë. Etnografi i njohur serb, J. Erdeljanoviç, ka kryer disa ekspedita studimore në ato anë, dhe numuri i toponimeve shqipe, makro e mikro, që ai ka evidentuar aty, është vërtet impresionues.²⁶ Erdeljanoviç e ka të vështirë të pranojë se një toponimi e tillë lidhet, gjithsesi, me një prani shqiptare aty, dhe insiston të nënvizojë, p.sh., se Kuçët “janë një nga fiset më të mëdha serbe të Malit të Zi”. Por, po ai detyrohet të pranojë se ky fis “nuk ka asnjë përkritje me ndonjë fis tjetër serb”.²⁷ Herë-herë ai flet për grupe e fise shqiptare si banorë të hershëm, madje qysh nga periudha ilire në krahina të veçanta, siç vepron, për shëmbull, me fisin Luhari në Fundanë, apo Bukëmirë e Mataguzhët në

²⁵ Arthur J. Evans, *Antiquarian researches in Illyricum*, pars I-II, Westminster, 1883, f. 33; M. Tadin, “Les Arbanitai des chroniques byzantines (XI-XII siècles)”, në: *Actes du XV^e Congrès Internationale des Études Byzantines*, vëll. IV: Histoire, Athènes, 1980, f. 315; Jadran Ferluga, “Byzanz und die Bildung der frühesten südslavischen Staaten”, në: *Byzantium on the Balkans*, Amsterdam: Adolf M. Hakkert, 1976, f. 249; “Božidar Ferjančić, “Dolazak hrvata i srba na balkansko poluostrvo”, *Zbornik Radova Vizantoloski Institut* 35 (1996), 136; Martin Eggers, “Das De Administrando Imperio des Kaisers Konstantinos VII Porphyrogenetos und die historisch-politische Situation Südosteuropas in 9. und 10. Jahrhundert”, *Ostkirchliche Studien* 56 (2007) 40, 41. Pasi nënvizon se Porpyrogeneti (shek. X), e përjashton një vendosje të Sllavëve në Diokle, pra jug të Gjirit të Kotorit (*Deukaterion*), Eggers shton se “banorët e Dioklesë cilësohen prerazi si jo Serbë”, dhe se në kohën e dyndjeve sllave, “në Diokle pati një përqëndrim më të madh se kudo tjetër në bregdetin Adriatik të popullsisë së vjetër romane e asaj shqiptare, përkatësisht ilire”.

²⁶ Po kufizohemi të rreshtojmë vetëm disa prej tyre: Mataguzhë, Bukëmirë, Qafa e Kishës, Lisi i Kishës, Nikmarash, Gropë, Thanë-Thanza, Buzë, Brinjë, Lug, Guri i Cakut, Gropë e Thellë, Sukë-Sukëzë, Drenikë (Ndrenikë), Maja Bogdanit, Rrethi Judhisht (Shkëmbi i Ullirit, sipas Erdeljanoviç, Shkëmbi i Judesë, sipas nesh), Kroni Blinit, Gropa Cukajt, Bregu Ploni, Fushë t’Bubit, Gropë t’Delajt, Qaf’Suka, Kroni Luharit, Gropë e Sharofit, Rudin’e Pleqe, Fush Bardha, Gropë e Bletës, Guri Gjat, Kodra Thanina, Gropë e Ujit, Nde Kishë, Mullini, Kuqishta, Bregu Mollës, Vathnë, Shalza, Maja Kunjit Djegun, Strunga Vojvodës, Shpella Dhine, Maja Kunorë, Shtegu Shkurtën, Pusi Kalit, Grop Kuqa, Dhi Bala, Bar Kali, Buza Dreca, (Buzë Dreqi, P. Xh.), Gropa Pelës, Shpella, Shullan, Kotec, K’solla, Trollishtë, Drizë, Lulan, Brijeg Pelev (Bregu Pelëve, P. Xh.), Kukë, Buronjë, Kumbulla, Shkalla, Suka. Shih: Jovan Erdeljanovic, *Kuci, Bratonozici, Piperi. Etnoloska Studija*, botim fototipik, Beograd: Sllovo Ljubve, 1981 (treguesi i emrave).

²⁷ Jovan Erdeljanovic, *Kuci, Bratonozici, Piperi. Etnoloska Studija*, botim fototipik, Beograd: Sllovo Ljubve, 1981, f. 4.

Kuç.²⁸ Por gjithmonë e bën këtë, duke u munduar ta afrojë në kohë e ta reduktojë gati në hiç praninë shqiptare në ato troje (“Shqiptarët jetojnë vetëm në skajin juglindor të Kuçit”).²⁹ Gl. Stanojeviq, që si historian ka një njohje më të mirë të burimeve historike, se ç’ka etnografi Erdeljanoviç, ka ndeshur në të dhëna të tilla, që flasin shkoqur për “popullsitë Shqiptare në Bardhë” (*li popoli Albanesi a Barda*). Për rrjedhojë, ai është i detyruar të japë një pasqyrë më të ekuilibruar të popullsisë së asaj treve edhe në shekujt më afër nesh.³⁰

Në fakt, siç u përmend më sipër, deri në fund të shek. XVII, burime historike i përcaktojnë prerazi fiset Bjelopavliq, Bratonesh, Pipër e Kuç si shqiptare (“*li popoli Albanesi a Barda*”).³¹ Gjithashtu, i vendosin ato brenda një kornizetë “maleve të Shqipërisë”, e cila përveç maleve të Bardhës, përmbledh edhe “malet” e tjera shqiptare, ato të Kelmendëve, Hotëve, Grudëve, Kastratëve, Shkrelëve, etj.³² Sigurisht, identifikimi i saktë i popullsisë të atyre malësve të paafrueshme e pak të njohura, ishte një punë e vështirë, dhe jo pa arsye mbi to vijnë edhe pohime kontradiktore. Kështu, në fillim të atij shekulli, në vitin 1614, Marian Bolizza nga Kotori, person i mirëinformuar e i besuar i Venecianëve, i përcakton Kuçët e maleve të Bardhës si Shqiptarë të besimit katolik, të prirë nga krerët e tyre, Lalë Drekalë e Niko Raiku.³³ Por, një burim tjetër i atyre viteve njofton se tashmë Kuçët ishin ndarë në “gjysma ortodoksë e gjysma tjetër katolikë” (*la metà*

²⁸ Jovan Erdeljanovic, *Kuci, Bratonozi, Piperi. Etnoloska Studija*, f. 134, 139, 161-162.

²⁹ Po aty, f. 1, 73.

³⁰ Gligor Stanojević, “Pokret Brdskih i Albanskih plemena yoçi Kandiskog rata”, në: *Istorijski Zapisi*, god XIII, knj. XVII, nr. 3, 1960, f. 513-514: “Nën fjalët *li popoli Albanesi a Barda*, nuk mund të kuptohen vetëm Shqiptarët, por edhe një pjesë e fiseve tona të Brdës”.

³¹ Gligor Stanojević, “Pokret Brdskih i Albanskih plemena yoçi Kandiskog rata”, në: *Istorijski Zapisi*, god XIII, knj. XVII, nr. 3, 1960, f. 513-521.

³² “*popoli e capi di Barda de Monti d’Albania, Cuzzi, Clementi, Hotti, Grude, Vassoevichi, Brattonosichi, Piperi e Bielopaulichi*”, ASVe, *Provveditori da Terra e da Mar*, b. 360: Zara, 31 mars 1688; Marko Jačov, *Spisi tajnog vaticanskog arhiva XVI-XVIII veka*, Zbornik za Istoriju, Jezik i knjizhevnost Srpskog Naroda, II Odeljenje, knjiga XXII, Beograd: Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, 1983, nr. 118, f. 132 (Kotor, 19 shkurt 1686). Shih këtu, shën. 17.

³³ “*del rito romano: Chuzzi Albanesi commandata da Lale Drecaou et Nico Raizcou*”, Rossana V. d’Alberon, “La relazione sul Sangiacato di Scutari: un devoto tributo letterario alla Serenissima da parte di un fedele suddito Cattarino”, në: *Studi Veneziani*, n. s. XLVI (2003), f. 330.

scismatica e l'altra latina).³⁴ Dekada më vonë, në vitin 1699, Kuçët rezultojnë të qenë kthyer në pjesën më të madhe në besimin ortodoks, ndërsa një pjesë më e vogël e tyre, Triepshët, vazhdonin të ruanin besimin katolik. Megjithatë, këto dy grupime të Kuçëve ishin aleatë (*confederati*).³⁵ Gjithësesi, edhe në vitin 1688, Boetius i konsideronte Kuçët shqiptarë, ashtu si dhe fisin tjetër të Pipërve.³⁶

Mbi këtë bazë, autorë modernë i konsiderojnë shqiptare popullsitë e maleve të Bardhës deri në mesjetën e vonë, ndërkohë që evidentojnë një proces të vazhdueshëm të sllavizimit të tyre³⁷. Në fakt, vetë *Zakoniku* i Stefan Dushanit (1349) është dëshmia e një politike të programuar, që synonte konvertimin e “mosbesimtarëve”, thënë ndryshe ithtarëve të herezisë latine, si edhe atë të “gjysmë-besimtarëve”, d.m.th ndjekësve të ortodoksisë bizantine, dhe aderimin e tyre në ortodoksinë serbe.³⁸ Këtij qëllimi do i shërbenin masat e dhunshme, nga dëbimi, damkosja, ekzekutimi eterodoksëve, okupimi i kishave “heretike” e konsakrimi i tyre e deri te “ripagëzimi sipas mënyrës së vetme të krishterë”.³⁹ Në fakt, dokumente të shek. XIII-XIV, posaçërisht shkëmbimet e zëmëruara të Papëve të Romës me mbretërit Nemanja e veçanërisht me Stefan Dushanin, tregojnë se politika e konvertimit të dhunshëm të katolikëve dhe

³⁴ Injac Zamputi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore e të mesme në shek. XVII*, vëll. I, Tiranë, 1963, f. 198.

³⁵ “diro de Cucci piccoli ovvero la popolazione detta Triepsci quali sono soggetti alla citta di Podgorizza citta de Turchi. Questi Triepsci sono da 60 case in circa. Per quanto ho inteso sono cattolici quantunque vi siano poche case de Turchi et sono confederati con li Cucci grandi scismatici”, shih: M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vëll. II, Città del Vaticano, 1992, f. 712. Shih edhe. Milan Šufflay, *Srbi i Arbanasi*, Beograd, 1925, f. 76.

³⁶ Christophor Boetius, *Des Glantz-erhöhten und Triumphleuchtenden Kriegs-Helms Römisch-kaiserlichen Majestät*, 5. Theil, Nürnberg, 1688, f. 438.

³⁷ Vialla de Sommières, *Voyage historique et politique au Montenegro*, vëll. I, Paris, 1820, f. 86; Jovan Erdeljanovic, *Kuci, Bratonožici, Piperi. Etnoloska Studija*, f. 73, 140; Kurt Hassert, *Beiträge zur physischen Geographie von Montenegro*, Gotha: Justus Perthes, 1895, f. 65; Constantin Jireček, *Geschichte der Serben*, I. Band (bis 1371), Gotha: F. A. Perthes, 1911; f. 152; Marie-Janine Calic, *Südosteuropa. Weltgeschichte einer Region*, München: C. H. Beck, 2016, f. 76; Elizabeth Roberts, *Realm of the Black Mountain. A History of Montenegro*, f. 3.

³⁸ A. Boué, *La Turquie d'Europe*, vëll. IV, Paris, 1840, f. 427; Stojan Novaković, *Zakonik Stefana Dušana*, Beograd, 1898, f. 153-154.

³⁹ Këto masa parashikohen në nenet 6, 7, 8, 9, 10 të Kodit të Dushanit. Shih: P. Xhufi, “Çështje të marrëdhënieve të Shqiptarëve me shtetin serb të Nemanjidëve në gjysmën e parë të shek. XIV”, në: *Arbërit e Jonit*, Tiranë: Pegi, 2006, f. 273-285.

ortodoksëve besnikë të kishës së Konstandinopojës, u zbatua në mënyrë sistematike dhe me rezultate të dukshme.⁴⁰

Proceset e asimilimit etnik pikasen edhe përtej maleve të Bardhës, edhe në Zetën (Crnagorën) e mirëfilltë. Siç e thotë në mënyrë magjistrale M. Šufflay, “Zeta dhe Shqipëria e Veriut përfaqësonin një njësi biologjike të veçantë: ato i bashkonte e njëjta plastikë, i njëjti gjak ilir dhe të njëjtat peripeci historike”.⁴¹ Por një shekull e gjysëm pas aneksimit të vendeve të Zetës nga Stefan Nemanja, në vitin 1346, papa Klementi VI deklaronte se ato vende banoreshin “nga të krishterë me gjuhë të ndryshme” (*que a fidelibus christianis diversarum linguarum inhabitantur*).⁴² Procesin e tjetërsimit mund ta ndjekim në mënyrë pak a shumë lineare tek familja drejtuese e saj, ajo e Crnojeviçëve. Siç mësojmë, para shek. XV, Crnojeviçët mbanin mbiemrin Jura (Gjura). Në vitin 1410, kreu i këtij fisi, Gjergj Jura, dhe vëllai i tij, Aleksi, quhen “shqiptarë”.⁴³ Pak më vonë në burimet flitet për “Crnojeviçët e quajtur ndryshe Gjurashtë” (*Zernovichi chiamadi Giurazy*).⁴⁴ Por më herët, në 18 tetor 1403, Senati i Venedikut kishte urdhëruar të hetohej “nëse ishte e mundur të bisedohej me Jurasheviçët dhe me Shqiptarët e tjerë” (*possendi tractare cum Jurassevich et aliis Albanensibus*).⁴⁵ Në një dokument sllav të një viti më vonë, 1404, përmenden dy vëllezërit “Gjurgje e Llesh Gjurasheviq” (*Đurđe i Lêš Đurašević*).⁴⁶ Në vitet 1421-1430, dokumentet e Venedikut e të Raguzës flasin për “*domino Goicino Crnoievich*”, për të cilin thonë se ishte zot në Shqipëri (*domino in Albania*) dhe se ishte shqiptar (*Goyzino Albanensi*).⁴⁷

⁴⁰ Augustin Theiner, *Vetera monumenta Slavorum meridionalium*, vëll. I, Romae, 1863, nr. 181, 280, 320, 355, 502, f. 129, 215, 236, 259, 348; O. Gorka, *Anonymi descriptio Europae Orientalis*, Cracoviae, 1916, f. 31; Brocardus, *Directorium ad passagium faciendum*, në: *Historiens des Croisades (Historiens Armeniens)*, vëll. II, Paris, 1906, f. 484-485; Sime Ljubić, *Listine o odnošajih izmjedju južnoga Slaventsva i mletačke republike*, vëll. III, Zagreb, 1868, f. 264; A. Theiner, *Vetera monumenta historica Hungariam Sacram illustrantia*, vëll. II, Romae, 1859, f. 8-17.

⁴¹ M. Šufflay, *Srbi i Arbanasi*, Beograd, 1925, f. 52.

⁴² A. Theiner, *Vetera Monumenta Historica Hungariam Sacram Illustrantia*, tomus I (1216-1352), Romae, 1859, f. 701.

⁴³ N. Jorga, *Notes et extraits pour servir à l'histoire des Croisades au XV^e siècle*, vëll. I, Paris: Ernest Leroux, 1899, f. 181.

⁴⁴ S. Ljubić, *Listine o odnošajih južnoga mletačke republike*, vëll. IX, Zagreb, 1868-1891, f. 303.

⁴⁵ *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia* (më tej: *Acta Albaniae*), ed. L. Thalloczy, C. Jireček, M. Šufflay, vol. II, Vindobonae: Adolph Holzhausen, MCMXVIII, nr. 741.

⁴⁶ *Acta Albaniae*, II, nr. 788 (shënimi 3).

⁴⁷ N. Jorga, *Notes et extraits*, I, 532; II, 191, 232; L. Thalloczy-C. Jireček, *Zwei Urkunden*

Në 1 janar 1428, Senati i Venedikut refuzoi t'u jape shtetësinë veneciane vëllezërve Gjergj e Aleks Gjuraşi, "fisnikë të Zetës, vend i Shqipërisë" (*nobilium Zente, partium Albanie*), pasi këta ishin përfshirë si shtetas serbë në Traktatin e vitit 1426 të Venedikut me despotin Gjergj Brankoviq.⁴⁸ Po atë vit, vëllezërit Aleks e Gjergj Crnojeviqi rishfaqen me mbiemrin e parë: *Alexio et Georgio Juras*. Dhe po aty, mbiemri i vjetër *Jura* shoqërohet në një rast edhe nga mbiemri më i ri, *Crnojeviq* (*Alexio e Zorzi Juras e Cenovici*).⁴⁹ Në fund, mund të kujtohet këtu, se në vitin 1460, duka i Bosnjës, Stefani, i këshillonte venecianët të ruheshin nga Crnojeviqët dhe "nga sjelljet shqiptare të tyre" (*de li suoi costumi albaneschi*).⁵⁰ Duke shkuar përpara me gati dy shekuj, në vitin 1611, dëgjohet të flitet për "Shqiptarët e Malit të Zi" (*gli Albanesi di Montenegro*).⁵¹ Duke patur parasysh të dhëna, si ato që u rreshtuan, nuk është e vështirë të nxirret një përfundim mbi dukurinë e asimilimit etnik e ritmet e tij në *Crnagorë*, pra në viset mes maleve të Bardhës dhe "Shqipërisë Veneciane". Përmendëm vektorin fetar, kishën ortodokse sllave, që e barti këtë dukuri, duke realizuar homologimin fetar e kulturor të shqiptarëve katolikë me elementin sllav. Ky proces tjetërsimi fetar në Shqipërinë e Epërme, që në rrjedhje të kohës çonte pashmangërisht edhe në tjetërsim etnik, vijoi edhe në shekujt e mëvonshëm, dhe këtë e dëshmojnë udhëtarë e misionarë, që vizituan e studjuan ato vise. Për t'u veçuar mes tyre është relacioni i At Giacinto Sospello i vitit 1652, i cili shkruan mbi bazën e të dhënave të mbledhur në mbarë Shqipërinë katolike nga misionarë të tjerë të Propaganda Fide-s dhe nga ai vetë.⁵² Lidhur me malet e Bardhës, objekt i studimit tonë, At Sospello vërren: "Këtu nuk dua të merrem me Zetën afër Shestanit, që është pjesë e Malit të Zi, ku zbatohet riti ortodoks dhe flitet gjuha sllave: populli i atyshëm nuk bën pjesë në kombin shqiptar. Por do flas për katër fise, ato të Piprëve, Bratoneshëve, Bjelopavliqëve e Kuçëve, të cilët për aftësitë e tyre të

aus Nordalbanien, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*, München und Leipzig, 1916, f. 141.

⁴⁸ S. Ljubić, *Listine*, IX, 10; N. Jorga, *Notes et extraits*, I, 465.

⁴⁹ *Acta Albaniae Veneta*, bot. G. Valentini, pars II, tomus 13, München: Rudolf Trofenik, 1972, nr. 3169, f. 85.

⁵⁰ *Acta Albaniae Veneta*, p. III, t. 24, nr. 7008, f. 261.

⁵¹ C. Horvat (bot.), *Monumenta Historiam Usocchorum Illustrantia*, pars II (1602-1620), Zagabriae, 1913, nr. 198, f. 93.

⁵² Njoftimin e parë për të e jep: T. Lewicki, *Un manuscrit inconnu du XVIIe siècle concernant l'Albanie et l'histoire des missions franciscaines dans ce pays*, extrait de la "Revue des Études Islamiques", année 1948, Paris: Librairie orientaliste Paul Geuthner, 1949, f. 57; Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*, Tiranë: Pegi, 2006, f. 37, shën. 57.

spikatura luftarake ngjajnë të kenë gjak Shqiptari, e në fakt të tillë konsiderohen nga Shqiptarët. Megjithatë, duke qenë se pothuaj të gjithë aplikojnë ritin ortodoks e flasin gjuhën sllave, mund të konsiderohen më shumë Sllavë, se sa Shqiptarë”.⁵³ Pas tij, në vitin 1675, edhe ipeshkvi i Shkodrës, Pjetër Bogdani, bën konstatimin, dhe njëherësh alarmin për rrezikun e “humbjes së gjuhës shqipe” nga ato popullsi shqiptare “që jetonin mes Turqve, Grekëve e Sllavëve”.⁵⁴

Në agim të kohëve të reja, ky proces asimilimi etnik kishte përparuar në mënyrë të pakthyeshme për pjesën më të madhe të pjestarëve të katër fiseve të maleve të Bardhës. Megjithatë, në ato vende e tek banorët e tyre kanë mbetur emrat e vendeve e të njerëzve, zakonet, elementë të gjuhës e të folklorit. Kanë mbetur në popull edhe legjendat për prejardhjen nga demiurgë shqiptarë.⁵⁵ Kështu, në Bjelopavliç tregohet se i pari i tyre, Pali, ishte nga fisi i Dukagjinëve.⁵⁶ Tek Kuçët jeton legjenda se themeluesi i atij fisi ishte nga familja Drekalë, kushuri i Gjergj Kastriot-Skënderbeut.⁵⁷ Bën përshtypje, që në kohët moderne, vetëdija e të qenit diçka ndryshe nga sllavi i mirëfilltë, ishte ngulitur edhe tek përfaqësues të shtresave të larta të shoqërisë malazeze, madje të integruar në rangjet më të larta të politikës e kulturës së atij vendi. Ky është rasti i Jovan Baljeviç, i lindur në Peleva

⁵³ “*Qui taccio il trattare della Zetta contigua à Sestano, qual'è parte del Montenero del rito serviano e lingua illirica, per non esser annoverata tra la nazione Albanese. Ma favellando delle quatro popolationi de Piperi, Brattonesi, Bielopaulovicchi e Cucchi, li quali per il loro gran valore nell' armi danno segno d'esser del sangue Albanesi e per tali dalli Albanesi sono tenuti; nulla di meno essendo quasi tutti del rito serviano e di lingua illirica, ponno più presto dirsi Schiavoni ch'Albanesi*”, Biblioteca Civica di Fermo: Mss. It., C. B XXX nr. 45: “*Relatione Universale dell'origine e successe della missione Apostolica de Frati Minori Osservanti Riformati del Serafico S. Francesco nel Regno d'Albania. Da diverse relationi d'alcuni Padri Missionari di dette missioni raccolta, ordinata et aumentata dal P. Giacinto Sospello, anno 1652, fol. 9. I jemi mirënjohës Dr. Bejtullah Destani, gjurmues e botues i arkivave e bibliotekave të mbarë Evropës, i cili më vuri në dispozicion tekstin e plotë të relacionit të Sospello-s.*

⁵⁴ M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani*, II, nr. 55, f. 377.

⁵⁵ C. Jireček, *Geschichte der Serben*, f. 153.

⁵⁶ J. Gardner Wilkinson, *Dalmatien und Montenegro, mit einem Ausfluge nach der Herzegowina*, II. Band, Leipzig: Verlag von Gustav Mayer, 1849, f. 26; William Miller, *The Ottoman Empire and its Successors (1801-1927)*, Cambridge, University Press, 1936, f. 142; I. Bozic, *Istorija Crne Gore*, vol. II, knj. 2, Titograd, 1970, f. 357; Branislav Đurđev, *Postanak i razvitak Brdskih, Crnogorskih i Hercegovačkih plemena*, f. 80.

⁵⁷ Mark Milani, *Jeta dhe zakonet e Shqiptarëve*, përkth. Lazër Radi, Tiranë: Muza, 2003, f. 124, 125; Jovan Erdeljanovic, *Kuči, Bratonožići, Piperi. Etnoloska Studija*, Beograd: SIllovo Ljubve, 1981, f. 137, 138.

Brijega (Bregu i Pelës) në vendbanimin e fisit të Bratoneshëve, në malet e Bardhës. Baljeviç ishte një personazh kontrovers, siç e tregon jeta e trazuar e tij prej politikani aventurier e autori librash e traktatesh të bujshëm. Mjafton të përmendim njerin prej tyre, shkruar në latinisht: *Dissertatio Philosophica de Propagatione Religionis Armata* (Disertacion filozofik mbi përhapjen e fesë me luftë), që do të vinte në siklet edhe Papa Urbanin I^{ri}, propagandistin e zjarrtë të Kryqëzatave në shek. XI. Por këtu përbën interes fakti, që që Baljeviç parapëlqen ta prezantojë veten, herë si “shqiptaromalazez nga Bratoneshi”, dhe herë thjesht si *Albanus* (shqiptar).⁵⁸

Një rast tipik përfaqëson Mark Milani, “vojvodë” i Malit të Zi në kohën e sundimit të knjaz Nikolla I^{ri} Petroviq Njegoshi (1860-1918). I lindur në Kuç të maleve të Bardhës, u shqua si luftëtar në betejat me osmanët dhe u bë krah i djathtë i knjaz Nikollës. Filoserb, aq sa të aspironte bashkimin e Malit të Zi me Serbinë (ai i konsideronte malazezët si popull serb), Mark Milani ishte armik i çështjes kombëtare shqiptare. Ai vetë tregon, se kur Perandori i Austro-Hungarisë dërgoi tek ai një emisar të vet për t’i propozuar kurorën e princit të Shqipërisë, Marku urdhëroi që t’i jepnin austriakut 100 shkopinj, “madje për ta nderuar si person të rëndësishëm, t’i jepnin 101”.⁵⁹ Siç arsyeton mprehtazi E. Knight, “Mark Milani, edhe pse ishte Shqiptar, siç ndodh me të gjithë renegatët, u bë armiku më i egër i kombit të vet, duke ndjekur ndaj tij një politikë lufte e agresioni”.⁶⁰ E megjithatë, siç ndodh shpesh me qëniet njerëzore, në pleqëri të thellë, edhe Mark Milanin “e zuri gjaku i të parëve” dhe u vu të shkruajë mbresat e kujtimet e jetës së tij. Libërthi i tij është një rrëfim i singertë e plot nostalgji për jetën në malet e Kuçit, një apoteozë e malësorit shqiptar dhe e virtyteve të tij të liridashjes, mikpritjes, nderit e besës. Me një brejtje ndërgjegjeje për të kaluarën e tij politike në shërbim të kauzës së huaj, Mark Milani e gjen me vend t’u japë një këshillë a paralajmërim serbëve, të cilët, sipas tij, do kishin vetëm fitim nga miqësia me shqiptarët. Por për ta fituar këtë miqësi, ata duhet t’i linin mënjane dredhitë e duhet të ishin të singertë me ta.⁶¹

⁵⁸ Dušan J. Martinović, *Dr Jovan Stefanović Baljević (Ili Šćepan Mali). Život i rad*”, Podgorica: DOB, 2002., f. 75, 135; Goran Sekulović, *Trpeljivost-Plata Ljudskosti. O Jovanu Baljeviću, prvom Crnogorcu doktoru filozofije 1728-1769*, Podgorica: Dukljanska Akademija Nauka i Umjetnosti, 2015, f. 10, 169.

⁵⁹ Mark Milani, *Jeta dhe zakonet e Shqiptarëve*, përkth. Lazër Radi, Tiranë: Muza, 2003, f. 138.

⁶⁰ Edward Frederick Knight, *Albania, a narrative of recent travel*, London: Samson&Rivington, 1880, f. 235, 236.

⁶¹ “Puno, o serb, me shqiptarët dhe do dalësh i fituar. Trokit në portat e tyre dhe ato do të

Fisi i Bjelopavliqëve, që siç u cek më sipër, besohet se rrjedh nga Pali i Bardhë,⁶² përmenden për herë të parë në vitin 1411 gjatë një sulmi plaçkitës ndaj një karvani të tregtarëve nga Raguza.⁶³ Ndonjë vit më vonë, në 1444, Bjelopavliqët ishin përfshirë në një aksion të ngjashëm, kësaj here kundër zotërimeve të vëllezërve Gjurash, Stefan e Koicin Crnojeviq, zotër të Malit të Zi. Bjelopavliqët ishin atë kohë nën urdhërat e qeveritarit venecian të Shkodrës.⁶⁴ Ky fis përmendet vazhdimisht në ngjarjet e vitit 1689-1691, kur Perandoria e Habsburgëve, nga njera anë, dhe Republika e Venedikut, nga ana tjetër, u përpoqën t'i joshin e t'i përfshinë ata dhe fise të tjera “të Bardhës së Maleve të Shqipërisë” në luftën kundër Portës së Lartë.⁶⁵ Në burimet historike që lidhen me ato ngjarje, fisi i Bjelopavliqëve shfaqet me emrin sllav të tij. Por, siç kishte paralajmëruar At Sospello në

hapen. Puno me besnikëri të vërtetë dhe mos u mbështet, as në shkathtësinë tënde dhe as në thjeshtësinë e tyre, duke menduar se mund t'i mashtrosh lehtë. Edhe sikur atyre të mos u shkojë nëpër mend se ti më tepër punon për lavdinë tënde, se sa për nderin e tyre, mos u lër shkas të ngulin mbi ty njëmijë shikime, për t'i zbuluar dredhhtë dhe mashtimet e tua. Mos e ul veten deri aty”. Shih: Mark Milani, *Jeta dhe zakonet e shqiptarëve*, f. 111.

⁶² J. Gardner Wilkinson, *Dalmatien und Montenegro, mit einem Ausfluge nach der Herzegowina*, f. 26; William Miller, *The Ottoman Empire and its Successors (1801-1927)*, Cambridge, University Press, 1936, f. 142; I. Božić, *Istorija Crne Gore*, vol. II, knj. 2, Titograd, 1970,

f. 357; Branislav Đurđev, *Postanak i razvitak Brdskih, Crnogorskih i Hercegovačkih plemena*, f. 80.

⁶³ C. Jireček, *Die Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien während des Mittelalters*, f. 71; Branislav Đurđev, *Postanak i razvitak Brdskih, Crnogorskih i Hercegovačkih plemena*, f. 80.

⁶⁴ “Nuy fradeli suprascriti havemo abudo de nostro patrimonio zerte vile fora del nostro paixe ali confini de Bosna cum lequal ville vegnissimo ala vostra Signoria, e le dite ville arobo Bielopaulovich, siando homeni de la Signoria e lo presente sono homeni de la vostra Sig.ia arobo zircha chaxe 300, in le dite chaxe fo facto danno zerca ducati mille. E per tanto pregemo la vostra Sig.ia se degna de scriver al Cap.de Scutari che debia commandar ali soprascriti Bielopaulichi che non se debiano impazar in le dite ville nostre”, AAV, p. III, t. 18, nr. 4993, f. 209: 4 korrik 1444.

⁶⁵ ASVe, *Senato, Dispacci: Provveditori da terra e da mar e altre cariche*, b. 360: Zara, 31 mars 1688: (popoli e capi di Barda de Monti d'Albania, Cuzzi, Clementi, Hotti, Grude, Vassoevichi, Brattonosichi, Piperi e Bielopaulichi); ASVe, *Senato, Dispacci: Provveditori da Terra e da Mar e altre cariche*, b. 529: raport i Pietro Duodo, Proveditor i Jashtëzakonshëm i Kotorit, 11 maj 1689 (tra quali v'entrano Piperi, Cuzzi e Trabonesich... e se vi s'aggiungesse... picciol squadra de Bielopaulichi, riuscirà molto più fruttuoso il servizio). Shih gjithashtu raportet e qeveritarëve venecianë të Dalmacisë e Shqipërisë: ASVe, *Senato, Dispacci: Provveditori da Terra e da Mar e altre cariche*, b. 529: Kotor, 1 tetor 1689; *Po aty*, Kotor, 20 nëndor 1689 (li Nixichi, Brobgnazzi e Bielopaulichi e diversi altri dalli monti di Barda); ASVe, *Provveditori da terra e da mar*, b. 531: Zara, 25 shkurt 1690.

1652, shqiptarët vazhdonin t'i konsideronin Bjelopavliqët bashkëkombase t'i thërrisnin me emrin shqip, *Palabardhë*, që do të ishte forma origjinale e tij.⁶⁶ E në fakt ekzistojnë të paktën dy të dhëna që e vërtetojnë këtë thënie të tij. E para është një relacion i vitit 1685 i Arqipeshkvit të Shkupit, Pjetër Bogdani, mbi gjendjen e besimit në dioqezën e tij, ku veç të tjerash, ai përmend edhe “popujt e pamposhtur të Kelmendit, Grudës, Pipërit, Palabardhit e Kuçit”.⁶⁷ Në vitin 1767, një tjetër shqiptar, Andrea Doda, Zvendës Konsull i Venedikut në Shkodër, në një letër për Pasquale Cicogna, Proveditor i Jashtëzakonshëm i Kotorit e i Shqipërisë, e informonte këtë të fundit mbi kontaktet që agjentë të Moskës kërkonin të vendosnin atë kohë me vendet e Pipërit, Palabardhit (*Pala Barsi*), Kuçit e Triepshtit.⁶⁸ Duhet shtuar, se emri “Palabardh” ruhet kështu, në trajtën shqipe, edhe larg atdheut të Palabardhëve dhe vetë trevës së maleve të Bardhës. E gjejmë kështu në një fshat buzë liqenit të Radoniqit, në Gjakovë (Kosovë). Për një fshat tjetër me emrin Palabardh (*Paugliebardo*), në Dalmaci, diku në rrethinat e Raguzës, flitet në vitin 1694, kur Këshilli i Madh i Raguzës proteston pranë Proveditorit të Përgjithshëm venecian në Zarë, për dhunën që një grup *hajdukësh*, shtetas venecianë, kishin kryer në dëm pikërisht të banorëve të fshatit Palabardh.⁶⁹ Ekzistenca e kësaj diaspore të emrit “Palabardh”, do të

⁶⁶ Biblioteca Civica di Fermo: Mss. It., C. B XXX nr. 45: *Relatione Universale*...dal P. Giacinto Sospello, anno 1652, fol. 9.

⁶⁷ “*I valorosissimi popoli de' Clementi, Gruda, Piperi, Palabardi e Cuci*”, A. Theiner, Mon. Slav. Merid., II, nr. CCXXXIII, f. 218; Marko Jačov, *Spisi tajnog vaticanskog arhiva XVI-XVIII veka*, f. 136; L. Marlekaj, *Pjetër Bogdani dhe Shqipëria e kohës së tij*, Shkodër: Botime Françeskane, 2008, f. 696; Peter Bartl, *Albania Sacra. Geistliche Visitationsberichte aus Albanien*, 5: *Diözese Skutari*, Wiesbaden: Harrassowitz, 2021, f. 213.

⁶⁸ “*Aviso V. E come li 28 del scaduto giunsero trenta Podgorizzani da cotesto Ecc.mo Memeht Passà, e portorono legato un uomo da Montenegro, che haveva mandato Czar Pietro di Moscovia per le ville con dette lettere à Pipari e à Palla Barsi (Palabardhi) e à Lusi et à Triepsti e quelle ville havevano risposto à quel Czar Piero, se si era e vero quell'imperator di Moscovia in qual si sia tempo sia; mò in aiuto per spargere il sangue per il decoro Reale e quella lettera si trovano dal Passà, e quel uomo del Montenegro si trova in arresto. Cuci non è soggetto di codesto Mecmeth Passà, ma credo che Piperi e Pallabarsi queste due ville credo che pativano de guai da cotesto Ecc.mo Memeth Passà, perche sono sotto questo comandante. La villa di Cuci e Triepsi(sic) queste due ville buttare di gente in circa tre mille persone. Ripersi e Palla Barsi, che sono soggette sotto questo comandante possono fare di genti intorno tre mille persone e più*”, ASV, *Inquisitori di Stato: Dispacci dai Rettori di Cattaro 1672-1767*, b. 258; Andrea Duoda për Pasqual Cicogna, Proveditor i Jashtëzakonshëm i Kotorit e Shqipërisë, Shkodër, 1 nëndor 1767.

⁶⁹ “*inoltre, nel villaggio di Paugliebardo tagliarono a pezzi Juan Rocogl, depredando tutti li suoi animali con tutta la robba di casa, che in fine incendiarono esprimendosi, ch'il tutto*

ishte një tjetër provë që trajta shqipe e tij ishte primare, dhe se trajta sllave “Bjelopavliq” është një kalk i saj. Përsërisim, shfaqja e fisit të Palabardhëve me formën sllave të emrit, Bjelopavliq, qysh në fillim të shek. XV, flet për një proces të avancuar sllavizimi të tyre. Proces ky, i fiksuar edhe në defterët osmanë të atij shekulli, kur në Palabardh regjistrohen forma të pëzjera shqiptaro-sllave të emrave brenda së njëjtës familje (*Vukdrag* djali i *Gjinit*, *Miça* djali i *Progonit*, *Gvozhden* djali i *Gjinit*, *Nika* djali i *Stepkos*, *Lleshi* i biri i *Radonjës*, *Guraqi* i biri i *Gjinakut*, *Petko* i biri i *Mleshit*, *Brata* i biri i *Dodës*, *Leka* i biri i *Prishliqit*).⁷⁰ Nga ana tjetër, emërtimi “Pali i Bardhë”, që tradita e tregon si themeluesin e fisit Palabardh, është një formë tipike fjalëformimi ndër shqiptarë. Kështu, nga fundi i shek. XVI përmendet një Pietro *Palicucchia* (“Palkuqi”), në ishullin Mezzo(Lopud), afer Raguzës.⁷¹ Akoma më shumë, një dokument venecian i vitit 1573 ofron një shëmbull analog të emrit të fisit Palabardh. Bëhet fjalë për kapitenin e një skuadre anijesh në shërbim të Venecianëve, i cili quhej *Otti Bianco*, d.m.th. *Hoti i Bardhë*, apo *Hot Bardhi*. Mund të ishte një emër lufte (pseudonim), por kjo nuk ka rëndësi për qëllim të analizës sonë. Ky Hoti i Bardhë kishte zënë anijen e një tregtari nga Ulqini, të cilën e rimorkjoi për ta çuar “për verifikim” në Kotor. Por në ujrat e Gjirit, karvani u sulmua nga disa anije turke të Castelnovo-s, dhe tregtari mundi të shpëtojë e të mbërrijë në Kotorin venecian “me vetëm një këmishë në trup”. Ngjarja kishte ndodhur para verës së vitit 1571, kur tregtari në fjalë iu bashkua një ekspedite veneciane kundër garnizonit turk të Lezhës, gjatë të cilit mbeti i vrarë nga një e shtënë arkebuzi. Megjithatë, ndonjë vit më vonë, i biri i tij, Vuksan Deda (*Vuxan Dede*) bëri padi kundër kapiten Hotit, duke i kërkuar dëmshpërblim shtetit venecian për dëmin e shkaktuar, humbjen e anijes dhe të mallit të rrëmbyer nga turqit e Castelnovo-s, ngjarje për të cilën ai bënte përgjegjës pikërisht Hotin në fjalë.⁷² Siç ndodhte shpesh me çështjet

operavano d'ordine di Burovich. Diedimo subito parte di questi assassinii così enormi tanto al sopraprovveditore di Cattaro, quanto al Provveditore Generale in Dalmatia”, shih: J. Radonic, *Dubrovacka Akta i Povelje (Acta et Diplomata Ragusina)*, Srpska Kraljevska Akademija, tomus IV, fasc. 2, Beograd, 1942, nr.DXXX, f. 322, 837.

⁷⁰ B. Đurđev, “*Novi podaci o najstarijoj istoriji brdskih plemena*”, Istoriski Zapisi, knj. XVII, sv. 1, Titograd, 1960, f. 12; Selami Pulaha, *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Tiranë: Akademia e Shkencave, 1974, f. 123-124, 296.

⁷¹ Sime Ljubic, *Dizionario biografico degli uomini illustri della Dalmazia*, Vienna: Lechner, 1856, f. 233.

⁷² “*esso Capitano per forza con dette sue barche lo rimurchiò nella Bocca di Cattaro, non permettendoli pur di parlare, dove furono assaltati da sei barche da Castel Novo, et una fusta per timor delle quali esso Capitano prese la fuga con le sue barche, lassando esso naviglio con tutto l'havere in preda ad essi Turchi, non havendo tempo pur esso mio padre,*

gjyqësore ku implikohej shteti venecian, procesi duhet të ketë vazhduar gjatë. Në fakt, nga një akt i vitit 1575 “i hartuar në zyrën e noterit, poshtë kështjellës së Ulqinit”, mësojmë se kapiten Hot Bardhi (*Bianco*) kishte reaguuar ndaj akuzës duke përzgjedhur një grup me dëshmitarë, të cilët do paraqesnin versionin e tij të ngjarjes. Interesant është, që në këtë dokument të dytë, noteri, në prani të dëshmitarëve dhe të vetë kapitenit nën akuzë, e shkruan emrin e këtij të fundit “*Othi Bardo over Bianco*”, pra duke e shoqëruar variantin italisht të mbiemrit me origjinalin shqip të tij, *Bardo=Bardhi*.⁷³ Siç shihet, këto të dhëna të fundit i japin një mbështetje të fortë çështjeve të shtrura në këtë punim, duke filluar nga çështja kardinale e bartjes së emrit në italisht *Barda*, që ndeshet shpesh në dokumentacionin venecian të shek. XVI-XVIII, nga arketipi shqip *Bardha*. Gjë që vërtetohet sapër trevën e thellë malore të Malit të Zi të sotëm, të banuar nga fiset e Kuçit, Bratoneshit, Pipërit dhe të Palabardhit, aq edhe për emra fshatrash e personash të veçantë me origjinë shqiptare. Termi sllav *Brda* që burimet letrare serbe nga shek. XIX e tutje i atribuojnë trevës në fjalë, është një *usus inproprius* që i është bërë përcaktorit shqip *Bardha* (Barda), duke iu larguar

et gli marinari di salvar le loro vite, non che aviar ad alcun danno; ma ridutosi in camiso à Cattaro privo de tutta il suo haver hebbe ricorso al predetto Cl.mo Proveditore, al quale presentate le giustificazioni di tal fatto, et supplicando la reintegrazione del danno patito...Sopra la qual fede paratosi esso mio padre si ridusse al servizio di Sua Serenità nella fidelissima sua città di Dalcigno, de dove poi andato con li Mag.ci suoi Regimenti in Alessio per far quella impresa combattendo con i Turchi, fù da una archibuggiata morto, come il tutto parendo à Vra Ser., oltra la testimonianza predetta, et lettera di mano del Cl.mo Prov.tor indircciata al Capitano Otti Bianco (cfr. ketu: “Otti Bardi over Bianco”, nr. 864) si può à pieno giustificare dalli ambasciatori di quella città hora sono à suoi piedi, oltra infiniti altri, et essendo io Zorzi predetto, mediante la divina gratia venuto dalli suoi servitii sano di Armata, et dovendo per la disposition delle leggi conseguir l'amontar delle predette biave già al predetto mio padre debito, et prontamente promessogli, et ricercandolo da esso Cl.mo Proveditore, pare che mi ricusi, dove che vedendomi derelitto, privo de parenti et beni, in questi miserandi successi morti, che persi al servizio di Sua Ser., che privo d'ogni favore, salvo che dalla buona et constantissima giustitia sua, dalla quale preso ardir sono à suoi piedi humilmente ricorso, supplicando l'innata pietà et giustitia sua, si degni per li meriti et del sangue sparso alli suoi servitii del predetto mio padre far reintegrar me povero del predetto amontar di esse biave, con quel miglior modo, che all'infinita sua prudentia parerà; acciò che in tanta miseria indutto almeno con detta pocha miela possi in parte soccorrere alli infiniti bisogni miei”. Shih: ASVe, Sen. Mar, filza 57: letër e Vuksan Dedës për qeveritarin venecian të Kotorit, dhjetor-shkurt 1573/4.

⁷³ “*In Christi nomine Amen. Anno nativitatis eiusdem Millesimo Quinquagesimo Septuagesimo Quinto, Indictione tercia, die vero sabbati vigesimo secundo mensis januarii. Constituido alla presentia di me nodaro e testimonii infrascripti del strenuo D. Othi Bardo over Bianco olim capitaneo d'Albanesi a piede nella città de Dalcigno...*”, ASVe, Senato Mar, filza 62: 22 janar 1575.

semantikës së tij e duke i lidhur gabimisht “malet e Bardhës” (*montagne di Barda*) me një fjalë sllave, *Brda*, që tingëllon thuajse identike me arketipin shqip, por që ndryshe nga ky, i referohet “kodrës”.

Pëllumb XHUFİ

SUMMARY

BRDA, or BARDHA?

During century XVIII the Principality of Montenegro (Crnagora) began to take its form; Cetinje was the seat of the principality that more or less included the hilly/mountainous territory of five *nahijes* (administrative units): Cernica, Rijeka, Katunska, Ljeshanska and Pjesivacka. On the west side the principality annexed coastal areas: Kotor, Budva, Bar and Ulcinj, known since the XV century as the “*Albanian Veneta*”. On the north and south, it extended its territories over the Nikshic, Podgorica, and Zabjak, whereas on the left side took over a vast mountainous region that for centuries represented the spirit of resistance against the Ottoman ruler. This area had been inhabited by well-known tribes of Kuçi, Piper, Bratones and Palabardh (Bjelopavlic).

The Palabardh was the first tribe that was integrated into the Montenegrin state; this had happened sometimes by the end of XVIII century and they were followed by other tribes. At this point emerged the official acts bearing the name *Brda*, which summarized territories where all those four tribes lived. Henceforth, Montenegro begins to be called the “*Principality of Crnagora and Brda*”; at the same time prince Petar I Petrovic Njegos began to be introduced with a comprehensive title: “*The prince of Crnagora and Brda*”. Since then, the terms “*Brda*” for the land and “*Brdjani*” for its inhabitants, apparently Slavic words, came into official use and become a part of geopolitical vocabulary for Montenegro.

Up to the end of century XVII the historical sources explicitly defines the Bjelopavlic, Bratones, Piper and Kuç as Albanian tribes (“*li popoli Albanesi a Barda*”). They were also placed within the frames of “Albania’s mountains”, which in addition to Bardha includes even other Albanian “mountains” as those of Kelmendi, Hoti, Gruda, Kastrati, Shkrelji, etc. The Slavic term *Brda* that Serbian literary sources of XIX century and henceforth attributed to the region in question, was an *usus inproprius* made to the Albanian determiner *Bardha* (Barda), departing from its semantics and mistakenly associating the “Mountains of Bardha” (*Montagne di Barda*) with a Slavic word *Brda*, which sounds almost identical to the Albanian archetype, but different to this, it refers to the “hill”.

